Shfleto për jetët e profetëve [paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta] dhe do të gjesh çudira në realizimin e sukseseve.

Shfleto për jetët e Sahabeve [Allahu qoftë i kënaqur me ta] që të mahnitesh me imazhet më madhështore të sakrificave për realizimin e sukseseve.

Lexo për biografitë e dijetarëve që të mësosh për sukseset dhe arritjet e mëdha që realizuan gjatë jetës së tyre.

Në vijim disa shembuj përkatës:

1. Suksesi i Zejd Ibn Thabitit në mësimin e gjuhës çifute në më pak se njëzet ditë, dhe këtë si përgjigje kërkesës së Pejgamberit [paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të.

2. Suksesi i Sahabeve [Allahu qoftë i kënaqur me ta] në kodifikimin e Kur'anit, punë kjo goxha e vështirë.

3. Suksesi i Ebu Bekrit [Allahu qoftë i kënaqur me të] në kodifikimin e Kur'anit.

4. Suksesi i Imam Zuhriut në fillimin e kodifikimit të Sunnetit në kohën e Halifes Omer Ibn Abdul Aziz [Allahu e mëshiroftë].

5. Suksesi i Imam Buhariut në kodifikimin e haditheve autentike dhe këtë pas një punë të lodhshme gjashtëmbëdhjetëvjeçare të shkrimit, udhëtimeve dhe vlerësimeve – kritikës.

6. Medito në veprat kapitale të shkollarëve myslimanë që flasin për vullnetin, entuziazmin dhe suksesin e madh.

7. Suksesin e Shejhul Islam Ibni Tejmijes për rezistencë ndaj të gjitha fraksioneve të kohës së tij, duke shkruar për secilin fraksion veç e veç.

Phoca PDF

8. Suksesi i liderëve myslimanë me gjithë kapacitetet e kufizuara ushtarake.

9. Suksesi i Muhammed Ibn Abdul Vehhabit në pastrimin e bindjeve të njerëzve nga njollat e shirkut dhe luftimin e të gjitha llojeve të idhujtarisë (shirkut) që ekzistonin në Gadishull.

10. Suksesi i Ibn Bazit për përhapjen e dijes, ndërtimin e xhamive, sigurimin e të ardhurave për thirrës anembanë botës, me gjithë faktin se ai ishte i verbër.

11. Suksesi i Imam Albanit në nismën e tij për studimin e Shkencave të Sunnetit dhe shërbimin atyre, duke i zhveshur nga gjërat që padrejtësisht iu janë mveshur.

12. Suksesi i shoqatave humanitare në botën islame për ndërmarrjen e nismave dhe realizimin e tyre për ndihma dhe mësim.

13. Suksesi i thirrësit të madh, Dr. AbduRrahman Semitit në përhapjen e Islamit në kontinentin afrikan. Gjatë misionit të tij ka arritur të ndërtojë katër universitetet, qindra xhami, trajnim të mijëra thirrësve ndërsa nëpërmjet tij Islamin e kanë pranuar katër milionë njerëz.

14. Suksesi i disa stacioneve televizive islame në ndryshimin për të mirë të bindjeve të gabuara përkitazi me fenë, dhe këtë nëpërmjet programeve dhe emisioneve të ndryshme fetare.

15. Suksesi i disa uebfaqeve islame në përhapjen e dijes së vërtetë dhe luftimin e fraksioneve të humbura.

16. Suksesi i disa spitaleve myslimane në shërimin e sëmundjeve që spitalet me renome botërore nuk ia kanë dalë dot.

17. Suksesi i disa kompanive të komunikimit në sigurimin e shërbimeve ekstra që kanë ndihmuar shumë në lehtësimin e shumë problemeve të klientëve të tyre.

Burimi: Denana.com

Përshtati në shqip: Sedat Islami

Phoca PDF